

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionale Kompanija za Uklanjanje Otpada

"PASTRIMI" sh.a.d.d.

Nr.br. 832 dt. 15.03.2023
Prishtinë - Prishtina



Në bazë të nenit 162 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe nenit 23 të Statutit të KRM "Pastrimi" Sh.A – Prishtinë, Bordi i Drejtorëve të KRM "Pastrimi" Sh.A, në mbledhjen e mbajtur më datë 15.03.2023, merr këtë:

V E N D I M

I. Ngritja e pagave për kategoritë si në vijim:

- 1.1 Shtatëdhjetë (70) Euro për pozitat në të cilat paga bazë ka vlerën prej 330 Euro, respektivisht për pozitat: Punëtorë fizik (Bartja, Higjienë publike);
- 1.2 Shtatëdhjetë (70) Euro për pozitat në të cilat paga bazë ka vlerën prej 338.49 Euro, respektivisht për pozitën: Vozitës i kategorisë "B";
- 1.3 Shtatëdhjetë (70) Euro për pozitat në të cilat paga bazë ka vlerën prej 345.61 Euro, respektivisht për pozitat: Inkasant të amvisërive, Automekanik, Axhustrator, Vozitës i kategorisë "C", Vozitës i kategorisë "C1", Vozitës i ngarkuesit (manipulant i makinave të rënda), Autoelektracist, Gomister, Lubrifikues, Shtëpiak, Autolarës, Manipulues i skipit;
- 1.4 Shtatëdhjetë (70) Euro për pozitat në të cilat paga bazë ka vlerën prej 355.24 Euro, respektivisht për pozitën: Dhënës i karburantëve;
- 1.5 Shtatëdhjetë (70) Euro për pozitat në të cilat paga bazë ka vlerën prej 389.48 Euro, respektivisht për pozitat: Kryepunëtor në mekanik, Kryepunëtor në higjienë, Kryepunëtor në bartje, Kryepunëtor;
- 1.6 Pesëdhjetë e nëntë (59) Euro për pozitat në të cilat paga bazë ka vlerën prej 411.85, respektivisht për pozitat: Vozitës i autoveturës, Vozitës i KE, Kryepunëtor i axhustratorve dhe mekanik, Kryepunëtor në mekanik, Kryepunëtor, Kryepunëtor në bartje.

II. Obligohet Shërbimi i Administratës për zbatimin e këtij vendimi.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit por efektet financiare vlejné nga muaji Prill i vitit 2023.

A r s y e t i m

Duke marrë për bazë kërkesat e vazhdueshme të Sindikatës së Pavarur të Punëtorëve të KRM "Pastrimi" Sh.A për rritje të pagave, gjendjen ekonomike në vend si dhe duke vlerësuar nevojën e procesit dhe organizimit të punës në kompani, angazhimin në punë si dhe përvojën dhe përgatitjen

profesionale të punëtorëve, Bordi i Drejtorëve të KRM “Pastrimi” Sh.A ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesues i Bordit të Drejtorëve të KRM “Pastrimi” Sh.A

Fatos Selimi



Iu dërgohet:

- *Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve;*
- *Sindikatës së Pavarur të Punëtorëve të KRM “Pastrimi” Sh.A;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore;*
- *Arkivit.*